



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 806/Prot.
15

Patos, më 25/04/2023

PROCESVERBALI I TAKIMIT 12 prill 2023

Vendi: "Njësia Administrative Zharrëz, Salla e mbledhjeve"

Ora e fillimit : 10:00

Ora e mbarimit : 12:00

Tema E Konsultimit: " Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"neni 18; Ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin Publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52 ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"; Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për Konsultimin Publik", si dhe VKB-së nr. 94 datë 19.12.2022 Mbi Miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së Projekt Buxhetit Afatmesëm 2024-2026 dhe Prjekt Buxhetit Vjetor për vitin 2024.

Pjesëmarrës: **Administratore e Njesisë Zharrëz znj. Polikseni Tupe**, *Specialist i Drejtorisë së Financës në bashki z. Andi Kola*, , *Koordinatorja e Konsultimit Publik znj.Suzana Hysenaj*, *Rreth 24 pjesëmarrës (Kryetarë të fshatrave, Banorë dhe fermerë të njësisë Administrative Zharrëz)*

Takimin hapet nga Administratore e Njësisë znj. Polikseni Tupe : në radhë të marë më lejoni t'ju falenderoj për pjesëmrrjen. Ky është takimi i parë që realizojmë për këtë vit i cili lidhet mbi

me marrjen e kërkesave prioritare për hartimin e projekt buxhetit afatmesëm 2024-2026 si dhe buxhetit për vitin 2023. Më lejoni që përpara se të kalojmë me marrjen e kërkesave buxhetore t'ju informojë se kjo është faza e parë e marrjes së kërkesave e cila do të pasojë me të tjera faza për shqyrtimin dhe rishqyrtimin e kërkesave për investime në njësinë tonë. Bashkë me ne sot është edhe punonësi i Financës i cili do të na prezantojë investimet e parashikuara nga bashkia për këtë vit kalelndarik me qëllim që secili prej nesh që kërkon të flasë të ketë të qartë në atë se çfarë do të kërkojë me qëllim që të mos jemi të përsëritshëm.




Administratore e Njësisë znj. Polikseni Tupe

Degjesë publike me temë:

“ Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024

Specialist i Financës pranë Bashkisë z. Andi Kola – të falenderit, sic e tha edhe Polikseni ne jemi në fazën e parë të marrjes së kërkesave për buxhetin e vitit 2023 dhe atij afatmesëm 2024-2026.



Specialist i Financës pranë Bashkisë z. Andi Kola

Degjesë publike me temë:


“ Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024

Specialist i Financës pranë Bashkisë z. Andi Kola – liston investimet e parashikuara për njësinë Zharrëz për vitin 2022

Administratore e Njësisë znj. Polikseni Tupe : Ne kemi eksperiencë pozitive dhe bashkëpunim frytdhënës jo vetëm me Kryetarët e fshatrave por me pjesën dërrmuese të banorëve tanë. Të gjitha takimet konsultative kanë për synim transparencën e pushtetit vendor me qytetarët e tij por padyshim që hartimi i një buxheti kërkon një punë të madhe dhe një angazhim imenjativ qytetar duke filluar qysh tani e deri në fund të vitit ku në këshill vjen drafti përfundimtar i buxhetit. Tani fjala është për ju lidhur mbi cdo sygjerim apo propozim për buxhetin.

Kryetar i fshatit Zharrëz z.Barjam Hazizaj - për fshatin Zharrëz kërkoj të ndërhyret në:

- sistemin e vaditjes përmes rezervuarit të Zharrës
- Në të gjithë fshatin të ndërhyet për ndricimin rrugor
- Të ndërhyet për shtrim të rrugëve me zhavorr mali sidomos te zona “Zabie”



Kryetar i fshatit Zharrëz z.Barjam Hazizaj

Degjesë publike me temë:

“ Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024

- Të bëhet pastrimi i vendit “Ura e arrave”si dhe të shikohet mundësia për ngritjen e urës
- – në fshatin Zharrëz kemi një problem lidhur mbi rrugën e varrezave të fshatit e cila është e dëmtuar. Gjithashtu pemët e mbjella janë problem pasi përbëjnë rrezik për dëmtim të qivureve.

Banor dhe fermer i fshatit Verbas z.Sherif Velaj :- Kryetari i fshatit tha problemet më kryesore por fshati në vetvetë ka shumë probleme ndaj kërkoj nga ana e bashkisë të ndërhyet në:

- Rrjetin elektrik të fshatit pasi nuk kemi tension në banesat tona
- Investimet e rrugëve kanë probleme me shtyllat e ndricimit pasi janë në mesin e trotuarit dhe bëhen pengesë për kalin ndaj kërkoj të spostohen



**Banor dhe fermer i fshatit
Verbas z.Sherif Velaj**

Degjesë publike me temë:

***“ Marrja e kërkesave prioritare
për hartimin e programit buxhetor
afatmesëm 2024-2026 dhe projekt
buxhetit për vitin 2024***

Administratore e Njësisë znj. Polikseni Tupe : është i drejtë shqetësimi i ngritur por problemi qëndron në faktin se kjo çështje nuk është në kompetencën e Bashkisë ndërsa lidhur me spostimin e shtyllave të ndricimit në rrugën e bërë, projekti ka qenë i miratuar më parë dhe kjo është punë e projektuesve gjithsesi ne do ta diskutojmë edhe me kryetaren nëse do të mund të bëhet ndonjë spostim

Kryetar i fshatit Belinë Hamza Grëmi – në fshatin Belinë dua të ngre disa probleme të cilat i kam ngritur edhe në dëgjuesat e tjera të realizuara më parë por duke qenë se procedura e kërkon po e shtroj përsëri shqetësimin tim si kryetar fshati lidhur mbi shtrimin e qendrës shëndetësore dhe kopshtit të fshatit.

- Edhe pse është kërkesë e përsëritur nuk na është dhënë asnjë përgjigje dhe në këto kushte nuk kemi se çfarë të kërkojmë.




**Kryetar i fshatit Belinë Hamza
Grëmi**

Degjesë publike me temë:

***“ Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e programit buxhetor
afatmesëm 2024-2026 dhe projekt
buxhetit për vitin 2024***

- Shtrim të rrugëve të brendëshme të fshatit atje ku ma nevojë për ndërhyrje
- Të ndërhyet për shtrimin e rrugëve me zhavorr mali
- Të ndërhyet për mirëmbajtjen e varrezave publike të fshatit

Banore e fshatit Belin znj. Barie Gëmi – kërkoj të ndërhyet për shtimin e rrugës nga qendra shëndetësore e deri te Faik Grëmbi dhe kërkoj që kjo rrugë të bëhet pasi është copë copë dhe nëse nuk e besoni ejani ta shikoni se në çfarë gjendje është ajo rrugë



**Banore e fshatit Belin znj. Barie
Grëmi**

Degjesë publike me temë:

*“ Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e programit buxhetor
afatmesëm 2024-2026 dhe projekt
buxhetit për vitin 2024*

Kryetar i fshatit Belinë Hamza Grëmi – padiskutim që fshati ka probleme por bashkia mua si kryetar fshati nuk me ka informuar lidhur mbi problemet e ngritur dhe nga ana e bashkisë nuk na u tha gjë konkrete. Gjithsesi problemet që do të ngrepër fshatin Belinë janë:

- Rikonstruksion i rrugës nga Llaq Naci deri te Ramadan Grembi
- Rikonstruksion i rrugës sëMëhenjtë
- Rikonstruksion i rrugës së Koceqëve
- Rikonstriksion i rrugës nga Thano deri te Kujtim Xhafa
- Fshati nuk ka sistem vaditje për tokat

Kryetar i fshatit Novosel z.Namik Plepi – për fshatin Novoselë kërkoj të ndërhyet ne dy projektet :

- Rikonstruksion i rrugës së ferrave
- Rikonstruksion i rrugës nga gabinës në mesin e lagjes
- Mungesë e ndricimit rrugor në lagjen që të con te rruga e ferave

- Lidhur mbi OSHE0në janë mbi 70 abonent që nuk kanë energji elektrike ndaj kërkoj në emër të fshatit të ndërhyet për blerjen e një transformatori.
- Fshati novosel ka probleme me sistemin e vaditjes pasi uji vjen me ngritje mekanike



Kryetar i fshatit Novosel z.Namik Plepi


Degjesë publike me temë:

“ Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024

- Lidhur mbi kanalet kullues ju keni bërë një punë të mirë por kërkoj të vazhdohet edhe njëë herë me pastrimin e kanaleve kullues
- Të bëhet shtrimi i rrugëve me zhavorr mali
- Investimi nga ana e përroti ka mbetur përgjysëm ndaj kërkoj vazhdimin e punimeve
- Pastrim i varrezave të fshatit

Kryetar i fshatit Verbas z. Luan Hoxha – për fshatin Verbas, kërkoj të ndërhyet në sistemin rrugror dhe përkatësishti:

- Rikonstruksion i rrugës në mesin e fshatit
- Rikonstruksion i rrugës nga Maaks Cepele deri te Artur Hoxha
- Shtrim të rrugëve të parcelave me cakull



Kryetar i fshatit Verbas z. Luan Hoxha


Degjesë publike me temë:

“ Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024

- Vazhdimi i projektit për investimin e rrugës së Majmërisë
- Spostim i gabinës elektrike e cila ndodhet në qendër të fshatit Verbas pasi përbën rrezik për kalimtarët
- Të ndërhyet për pastrimin e kanaleve në mesin e fshatit
- Fshati ka probleme me sistemin e vaditjes
- Të merren masa për pastrimin e kanaleve nga mbeturinat e serave
- Fshati vuan mungesën e ndricimit si në banesa ashtu edhe në rrugët e lagjeve

Kryetar i fshatit Sheqishte z. Afrim Grëmbi – për fshatin Sheqishte, kërkoj të ndërhyet në sistemin rrugor dhe përkatësishti:

- Ndërhyrje urgjente në sistemin e rrjetit elektrik nga rruga Sheqishte-Fier deri të zona e banuar
- Ndërhyrje në shtrimin e rrugëve të parcelave me cakull si dhe strim të rrugëve në mlagjet e fshatit atje kku ka nevojë për ndërhyrje



Kryetar i fshatit Sheqishte z. Afrim Grëmbi

Degjesë publike me temë:

“ Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024

Kryetar i fshatit Frashër z. Irakli Zarka – për fshatin Frashër, kërkoj të ndërhyet në sistemin rrugor dhe përkatësishti:

- Rikonstrukcion i segmentit rrugor Novosel -Frashër
- Rikonstrukcion i rrugës nga Llaq Kalivaci deri te Nasi Tole
- Të ndërhyet për sistemin e ndricimit rrugor në lagjet e fshatit
- Të ndërhyrjt për shtrim të rrugëve të parcelave me caakull
- Tëndërhyet për shtrimin e rrugës anës përroit nga Jani Dimo deri te vendi ku ndan me fermën të shtrohet me cakull

- Vazhdim i shtrimit të rugës anës strugës me cakull,(300 m shtrim me cakull)



Kryetar i fshatit Frashër z. Irakli Zarka

Degjesë publike me temë:

“ Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetit për vitin 2024

Administratore e njesise Zharrëz znj. Polikseni Tupe – padyshim që cdo sygjërim i juaji është tepër i vyer për bashkinë. ndonjë kërkesë tjetër? Me qenë se jo, e deklaroj këtë seancë të parë dëgjimore për Buxhetin Afat mesëm 2024-2026 të mbyllur.

Konceptoi:

Koordinator i Konsultimit Publik

Suzana Hysenaj

Pranoi:

Sekretar i Këshillit

Balil Balili



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Zharrëz më, 12.04.2023

LISTË PREZENCË PJESËMARRJE NË DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:
“MARRJE E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PBA-SË 2024-2026 DHE BUXHETIT TË VITIT 2024”

Nr	Emër	Mbiemër	Njësia /Fshati	Profesioni/ Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1	Novinik	Shpirt	Fshat - R	Kryetar Fshat	0692472944	
2	Barryam	Rayuqaj	Zhelez	Kryetar Fshat	0695655042	
3	NIRON	GRËMIRI	SHtrugushkë	FERMER	0684822053	
4	Albim	Crembri	SHtrugushkë	K. F. Shqiptar	0692105173	
5	Shenif	Udaj	Zhelez	Fermer	—	
6	Donida	Aspioni	Razmë	Fermer	0683622173	
7	Keerlet	Begaj	SHtrugushkë	Fermer	—	
8	Irasti	Zarka	Frashev	Kryetar	0694614885	
9	Arta	Gruda	Belivë	Kryetar	0694853716	
10	Asan	Hotia	Verbas	Kryetar	0696528890	
11	Basim	Grum	Belin	Pendjor	—	
12	Arta	Grum	Belin	Pendjor	—	
13	Arta	Grum	Belin	Pendjor	—	

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008” Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 “Përpunimi për qëllime shkencore dhe statistike” Të dhënat personale, të mbledhura për

qfarëdoqllloji qëllimi, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistike, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të

konfidencalesh, të cilat janë të detyruara të ruhen në mënyrë konfidenciale. Përpunimi i të dhënave personale për qëllime gazetarie, literare ose artistike. Përfshihet nga çartimi nën 5, 6, 7, 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Zharrëz më, 12.04.2023

LISTË PREZENCË PJESËMARRJE NË DËGJESËN PUBLIKE ME TEMË:
“MARRJEN E KËRKESAVE PRIORITARE PËR HARTIMIN E PBA-SË 2024-2026 DHE BUXHETIT TË VITIT 2024”

Nr	Emër	Mbiemër	Njësia /Fshati	Profesioni/ Pozicion	Nr. Kontakti	Firma
1	Hadismina	Hoxha	Zhanne Z	Biljib.	0694706411	
2	Elis	Erëmi	Belinë	Fermer	0688244190	
3	Jetksemi	Tyba	Zhanig	Administratore	0695225287	
4	Andi	Kolla	Patos	SP Finance/ Buxheti	0676655762	
5	Aimilla	Piso.	Selk/ qy. Kulla	Polos	0692497832	
6	Juzana	Hysenaj	Polos	Koordinator i punës/ themit	0694881460	
7	Quisaura	Gropa	Polos	Kordinator i jefepublik	0699480612	
8						
9						
10						
11						
12						
13						

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008” Për Mbrojtjen E Të Dhënave Personale, Neni 10 “Përpunimi për kërkime shkencore dhe statistikore.” Të dhënat personale, të mbledhura për çfarëdoqilloj qëllimi, mund të përpunohen më tej për qëllime shkencore ose statistikore, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Të dhënat personale të koduara përdoren vetëm nga persona, të cilët janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin. Përpunimi i të dhënave personale përdoret vetëm për qëllime gazetare, literare ose artistike. Përyshkohet nga zbatimi nënet 5, 6 7 8, 12, 18, 21 e 28 të këtij ligji, vetëm nëse mbrojtja e të dhënave personale, sipas këtyre dispozitave, pengon ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes.